



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: “ARTMOTION” SH.P.K.

Numri Unik Identifikues: - 810200866

Pronar: “AM INVEST GROUP” SH.P.K

NUI: 810874538

Pronar: “AM INVEST GROUP HOLDING DOOEL”, Skopje


Numri i regjistrimit të biznesit (EMBS): 7177496

Pronari: Valon Shala

OSHMA: Big Brother 2

Adresa: Rr/Lidhja e Pejës, Zona Industriale

Prishtinë



VENDIM

për licencimin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Adiovizuale “Big Brother 2” për transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes – me seli në Prishtinë

Faktet


1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2021/01, ka hyrë në fuqi më datën 17 dhjetor 2021, përmes së cilës ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operator të shpërndarjes.
3. Më datën 26 korrik 2022, kandidati “Big Brother 2”, ka parashtruar aplikacionin për licencë të KPM-së për të vepruar si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes, me përmbajtje tematike të skemës programore “Reality Show”.

Arsyetim

4. Zyra Ekzekutive vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së OSHMA “Big Brother 2”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2021/01.
5. Zyra Ekzekutive vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “Big Brother 2” ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit konsiderohen të qëndrueshme sa i përket skemës programore në përgjithësi; të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, përfshirë edhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.
6. Sipas Nenit 15, paragrafit 5 të Rregullores KPM-2021, kandidati për licencë të KPM-së “Big Brother 2”, duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
7. Zyra Ekzekutive vlerëson se, kandidati “Big Brother 2” ka përmbushur kriteret kualifikuese për t’u pajisur me licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, në pajtim të plotë me Rregulloren KPM-2021/01.

Vendim

8. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 26 shtator 2022, merr vendim që, kandidatit “Big Brother 2”, me seli në Prishtinë, t’i lëshoj licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale përmes operatorëve të shpërndarjes, si kanal me përmbajtje programore tematike, në Republikën e Kosovës.
9. Në rast të shkeljes së dispozitave të Kodit i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale (KKPM – 2016/03) dhe Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale (KKPM 2013/01), gjatë transmetimit të programit, atëherë KPM ruan të drejtën e kërkesës për kodim apo ndërprerje të kanalit Big Brother 2.
10. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat Latifi
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



29.09.2022
datë